

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DREJTUES
TË RTSH-SË PËR VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- Këshilli Drejtues i RTSH-së ka rritur ndjeshëm veprimtarinë e tij, duke zbatuar kërkesat e ligjit dhe rritur imazhin e RTSH-së si një institucion serioz publik kombëtar, siç e përcakton ligji.
- RTSH-ja meriton vlerësimet maksimale për punën e kryer në drejtim të arritjeve të treguesve ekonomiko-financiarë, duke rritur ndjeshëm të ardhurat për institucionin, duke mundur një vit rekord të të ardhurave të vetë RTSH-së, si dhe duke siguruar një përdorim efektiv të këtyre të ardhurave në dobi të tërë veprimtarisë, në përmirësimin e parametrave cilësorë në shërbim të publikut.
- Këshilli Drejtues dhe titullarët e RTSH-së kanë bërë përpjekje serioze në drejtim të përdorimit të këtyre të ardhurave, që i shërbejnë rinovimit të teknologjisë në sistemin e prodhimit, përmirësimit të kushteve të punës dhe rinovimin fizik të mjediseve të institucionit.
- RTSH-ja ka bërë përpjekje dhe për dixhitalizimin, duke synuar të shndërrohet në një konkurrent dinjitoz në tregun mediatik.

Kuvendi vlerëson se:

- RTSH-ja vlerësohet për mbulimin mediatik dhe pasqyrimin dinjitoz të tërë veprimtarisë së zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të ngjarjes më të madhe kombëtare të vitit 2012, 100-Vjetorit të Pavarësisë.
- Përfshirja sistematike e tematikës në programacion, përmes trajtimit të përjavshëm të problematikave të ndryshme, të lidhura me ngjarjet dhe protagonistët në emisione, kanë sjellë risi përmes ofrimit të një dokumentacioni të ri nga institucione shumë të rëndësishme të vendit, përzgjedhjes së botimeve të shumta të këtij viti, dokumentarët e përgatitur, kronikat, intervistat etj., duke arritur kulmin e tyre me festimet në Vlorë e kryeqytet më 28 Nëntor 2012.
- RTSH-ja, në sajë të përmbushjes me sukses të detyrimeve ligjore, është një televizion i paanshëm, që në programet e tij editoriale transmeton në mënyrë të balancuar veprimtarinë politike të pozitës e opozitës.
- Një vlerësim të veçantë meriton ky institucion publik sidomos për zgjerimin e ndjeshëm të strukturës programore, në larminë e programeve të ofruara për teleshikuesit, të cilët tashmë e shikojnë RTSH-në si një transmetues të admirueshëm, që qëndron gjithnjë e më shumë pranë publikut.
- Zgjerimi i strukturës programore ka ofruar mjaft programe të reja që pasqyrojnë veprimtarinë historike, kulturore, shkencore e sportive brenda vendit, si dhe atë në arenën ndërkombëtare. Kjo ka nxitur dhe rritur njëkohësisht forma të dialogimit qytetar, përfshirjen gjithnjë e më shumë të shoqërisë civile dhe brezit të ri në këtë dialogim që, për rrjedhojë, ka sjellë një rritje numerike të dëgjuesve e shikuesve ndaj këtij operatori.
- Është për t'u përshëndetur RTSH-ja për fillimin e transmetimeve eksperimentale numerike, siç është programi RTSH HD, me rastin e Euro 2012 dhe Lojërave Olimpikë, Londër 2012 etj.
- Janë bërë shpenzime efikase në shtimin e prodhimit, blerjen e të drejtave ndërkombëtare të aktiviteteve të ndryshme sportive, filmave e programeve të ndryshme.

Për sa më sipër, Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së:

- Ashtu si në vitin e kaluar, Kuvendi rithekson se duhet të vijojë puna e nisur me ritme akoma më të shpejta në drejtim të rinovimit të teknologjisë dixhitale të RTSH-së dhe përshtatjes së saj me stafin e kualifikuar profesional.
- Përmirësimi mjaft i ndjeshëm në drejtim të larmisë së strukturës programore gjatë vitit 2012 duhet të bëhet burim nxitjeje për RTSH-në në përdorimin gjithnjë e më shumë të formave efektive të dialogimit qytetar, sidomos për fëmijët e të rinjtë, që ata të afrohen gjithnjë e më shumë me librin, mësimin me vlerat më të arrira të shoqërisë e të mos bëhen pre e fenomeneve negative.
- Të vijojë puna e nisur në drejtim të përgatitjes së personelit teknik, nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe rekrutimit të njerëzve të rinj, të aftë, që i përgjigjen stadi të teknologjisë moderne.

- Me miratimin e ligjit të ri “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e Përgjithshme e Radiotelevizionit Shqiptar të rrisin rendimentin e punës së strukturave të RTSH-së për plotësimin me sukses të detyrimeve ligjore.

Miraturar në datën 25.3.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)